Të gjitha pajisjet shtesë dhe pajisjet mjekësore të jenë të fiksuara drejtpërdrejt në trupin e automjetit. Pajisjet kryesore dhe struktura fiksohen në telajon e mjetit nëpërmjet sistemeve lidhëse.




Raftet- Raftet duhet te jene te derdhur, të përbërë nga vetrorezinë ose polyretan me bazë këndore të rrumbullakosur dhe të qëndrueshem ndaj goditjeve, rezistent ndaj materialeve te pastrimit, desinfektimit dhe djegjes.

Pjeset e brendëshme ne hapsirën e emergjencës, kabinës së pacientit, të jenë pershtatura per te shfrytezuar sa me mirë hapsirat.

Rafte të jenë mbi përforcimet e çelikut që përdoren për fiksime të sigurtë të njësive shtesë që janë të fiksuara mbi të, me mbyllje të siguruar.

Këto mobilje duhet të jenë me kanata prej xhami me lëvizje bidireksionale, për të shmangur rënien e paisjeve të vendosura në to.



Vende të posacme:

Në anën e majtë të pjesës së pasme të autoambulancës të jenë të montuar rafte dhe të ketë vende të posacme me material vetrorezine, rezistent ndaj flakes, të certifikuara prodhuesi sipas ISO 9001:2015, pajisjet sipas CE dhe [SSH EN 13501-1:2007+A1:2009](#) dhe SSH EN 1789:2007+A2:2014, të përshtatur për vendosjen e aksesorëve si më poshtë:

1. Set imobilizimi për frakturat e gjymtyrëve (splint tre masa)
2. Barela lëvizëse me dyshek.
3. Monitordefibrilator,
4. Bllokues i kollonës cervikale (qafore)
5. aspirator,
6. respirator,
7. Barrele (traume spinale) per shtyllen kurrizore dhe bllokues koke
8. Sistem nxjerrje dhe imobilizimi spinal (KED, Kendrick Extrication Device)
9. Barrelë mushama
10. Spider(Rrip sigurimi)

11. Gërshërë Robin
12. Pompe thithese portative (aspirator),volumi thithes min 1 000 ml, 12 V dhe 220 V
13. Monitordefibrilator per autoambulancat
14. Karroca Transportuese
15. Çanta e autoambulancës
16. Barelë Lugë
17. Karroca lëvizëse portative
18. Bombul zjarrfikëse(estintor) 2 kg
19. Çanta e emergjencës mjekësore për autoambulanca
20. Frigorifer autoambulance
21. Ventilatori Pulmonar

Tavani i autoambulancës:

Të jetë i veshur me material vetrorezine qe mund te pastrohet dhe desinfektohet lehtesisht.


Të ketë ndricim maksimal në hapsirën e kabinës së pacientit.

Forma të lejojë futjen e një platforme me qark të dyfishtë për dritën, si gjatë ditës dhe gjatë natës, lehtësisht të inspektueshme, të aspiratorit për ajrim dhe qarkullim të ajrit, të ketë dy mbajtëse serumi të fiksuar në tavan, të ketë dorezë mbajtëse për personelin. Drita suplementare me ndriçim të përqëndruar.



Dyshemeja e autoambulancës:

Dyshemeja të jetë me material të përshtatshëm, të mbulohet me një lloj materiali biokomponent, që e bën sipërfaqen e saj jo të rrëshqitshme, antigërvishtje, lehtësisht të dezinfektueshme dhe të thjeshtë për tu larë dhe pastruar.




Dera anësore:

Të jetë e rrëshqitshme, e veshur dhe me izolim, të ketë dy doreza të forta të instaluara në murin anësor dhe të pasëm pranë dyerve, për të lehtësuar ngjitjen e personelit në autoambulancë. Të ketë dritare me xhama rrëshqitës.



Dera e pasme: Me dy dyer me hapje 180°, dyert e pasme të mjetit të jenë me xhama.



Strukturë alumini kundër rrëshqitjes

Veshje e shkallës së pasme dhe anësore të jetë me veshje alumini kundër rrëshqitjes dhe për ruajtjen e dyshemesë së ambulancës.

Shkallë anësore për tu ngjitur në autoambulancë me hapje mekanike e sinkronizuar me hapjen e derës anësore

Dritaret:

Të jenë të mbuluara me xhama opake ose të veshur, me shirita midis tyre që lejojnë shikim.



Bombul zjarrfikëse(estintor) 2 kg:

Të ketë dy bombula(estintor) 2 kg një në kabinën e shoferit dhe një në pjesën e pasme të autoambulancës.

Instalimet Elektrike

Instalimi në kabinën e autoambulancës të një lllambe me sistem fizarmonikë LED, që i mundëson shoferit shikimin e hartës rrugore gjatë natës pa e shpërqëndruar nga drejtimi i mjetit. Instalimi i linjave 12V të lidhur direkt me baterine.

Cdo lidhje të ketë një siguresë të vecantë dhe të gjithë të kenë një siguresë kryesore.

Në murin e majtë të ketë të montuara priza elektrike 12V (furnizimi me energji elektrike për karikim monitordefibrilatori, aspiratori, frigoriferi i medikamenteve dhe paisjeve që kanë nevojë për karikim).

Ngarkesë shtesë / inverter 12 / 220V 500hz. Konektor i drejtpërdrejtë 220V me 2 fole 220V (sipas EN1789).

Implant me dy bateri nga 100A. Realizimi i një sistemi ushqyes me dy bateri. Bateria ndihmëse ushqen e vetme të gjithë ngarkesën elektrike të instaluar. Në rast defekti të baterisë kryesore, një paisje manuale lejon të lidhet bateria ndihmëse me motorrin e autoambulancës për ta ndezur. Në rast defekti të bateris ndihmëse është e mjaftueshme ndezja e motorrit për të ushqyer të gjitha paisjet elktromedikale me energjinë e prodhuar nga dinamoja e mjetit. Sistemi shfrytëzon baterin e parë të mjetit, një bateri e dytë e mbyllur hermetikisht sipas normave e instaluar në gabinën e mjetit. Struktura dhe lidhjet të jenë të realizuara në mënyrë që të evitojnë çdo mundësi të një lidhjeje të shkurtër.



Aspirimi dhe Ventilimi në tavanin e autoambulancës:

Ventilimi të jetë vendosur në tavanin e ambulances. Ky veprim aktivizohet me një buton në pjesën e emergjencës. Daljet e aspirimit dhe ventilimit të jenë të pavarura nga njëra tjetra.



Ngrohje e pavarur me ngrohës(turbinë) që prodhon ajër të ngrohtë me dalje nga posht-lart, në mënyrë të pavarur nga motori, në pjesën e pasme të autoambulancës (sipas EN 1789).

Ndriçimi për pjesen e emergjences

Në tavan, të jenë vendosur 4 dritat të pavarura mbi barelën e cila lejon ndriçimin në të gjithë trupin e pacientit. Në të gjithë gjerësinë e automjetit të ketë ndriçim NEON. Dritat të jenë me timer dhe aktivizohen automatikisht kur hapen dyert. Dritat të jenë të pavarura nga pjesa e drejtimit në pjesën e emergjences.



Sediljet

- Nje sedilje të jetë ngjitur me murin ndarës të gabinës në pjesën e pasme të mjetit, nga jashtë e veshur me material imitim lëkure, e pajisur me rrip sigurimi me tre pika fiksimi dhe me dy mbështetëse duarsh në 2 pjesët anësore.

Një sedilje të jetë në pjesën anësore djathtas, anash barrelës së pacientit, nga jashtë e veshur me material imitim lëkure, e pajisur me rrip sigurimi me tre pika fiksimi dhe me dy mbështetëse duarsh në 2 pjesët anësore.

Numri i përgjithshëm i ulëseve në dhomën e pacientit të jetë minimalisht 1+1.

Të plotesojne standartet SSH EN 1789:2007+A2:2014,


Materiali rezistent ndaj detergjenteve te pastrimit dhe desinfektimit

Dritat

-Drita LED te vendosur në 2 grupe mbi çatinë e mjetit.

- Në parakolp të kete vendosur 2 drita me sinjal Blu.

- Paneli i kontrollit te gjendet në kabinë të shoferit.



- Ndriçimi dhe Paneli i kontrollit në kabinën e pacientit të autoambulancës

Të ketë një panel komandimi që shërben në pjesën e pasme të autoambulancës për kontrollin e impianteve dhe aparaturave të instaluara në bordin e mjetit. Funksionet e parashikuara janë drita gjatë ditës ON/OFF, drita blu nate ON/OFF, ndezje e dritave normale të dollapëve të brenshëm ON/OFF, ngrohje ON/OFF. Buton ndezje për aspirim, ventilim dhe ajrim me rregullues. Butonat janë të ndriçuar me ndezje të thjeshte ose touch screen.

Pamja e jashtme e autoambulancës:

Logot e autoambulancës te vendosura në mënyre të dukshme dhe fluoreshente për shikimin gjatë natës.

Aksesorë të tjerë

- kosh i plehrave, pajimet në derën e pasme, cekic/ leve dhe pajisja për mbrojtje nga zjarri.

IV. Specifikime teknike të pajisjeve dhe aparaturave mjekësore të kabinës së

pacientit.

GARANCIA : 2 vjet për paisjet dhe aparaturat mjekësore.

Ambulanca duhet të ketë këto paisje dhe aparatura mjekësore si më poshtë:

Sistemi për oksigjen

-2 bombula oksigjeni 2 litra të transportueshme të pacienti. Të kenë reduktor(manometër) për çdo bombël. Të kenë fole për çdo bombël oksigjeni.

-2 bombula oksigjeni autoambulance statike të vendosura në pjesën e pasme të autoambulancës me volum 7 deri në 10 litra secila.

-Të kenë reduktor(manometër) të presionit me manometër.Të kenë fole për çdo bombël oksigjeni.

-Matës i rrjedhjes me një normë 0-15 l/min me një umidifikues(lagështues).

Pajisjet e sistemit të oksigjenit duhet të plotësojnë standartet SSH EN 1789:2007+A2:2014, ISO 9001:2015, CE dhe standartet për pajisjet e gazrave nën presion.

-Paisje dhe aparatura mjekësore për autoambulanca:

1-Barela lëvizëse me dyshek.



Të ketë barele me katër rrota me mundësi manovrimi për tu transportuar dhe ngarkuar në autoambulancë, me lartësi të ndryshme, me material polikromatik, e paisur me një strukturë dyshemeje, e përbërë prej polietileni me dendësi të lartë, me krahë me sistem hapje/mbyllje të shpejtë, me rrip sigurimi dhe sigures për shkurtim dhe zgjatim të tij, të integruar dhe me sistem fiksimit të certifikuar 10G. Barela të palosëshme.

Përmasat e barelës të jenë nga 1840 deri në 2000 dhe gjerësi nga 550 deri në 600 mm. Peshë e barelës jo më shumë se 45 kg dhe mund të mbajë peshë deri në 250 kg, gjithashtu të ketë frenat e pasme, të ketë 4 rrota të rrotullueshme të aktivizueshme me sistemin nga ana e këmbëve të pacientit. Të ketë sistem të ngritjes së pjesës së këmbëve (Trendelenburg).Të ketë dyshek për barelën sipas SSH EN 1865-1:2010+A1:2015 dhe CE 93/42

-Bllokimi i barelës.

Sistem bllokimi anterior dhe posterior për barelën e testuar sipas "10G", në konformitet me kërkesat dhe normat teknike EN 1865 e EN1789.

Plani horizontal i barelës të ketë një suport me sistem spostimi anësor. Plani të jetë i përbërë me material alumini, lehtësisht i pastrueshëm. Sistemi i lëvizjes anësore të ketë bllokues dhe lirues në disa pika të këtij plani, rrëshqitës për të lehtësuar ngjitjen e barelës në autoambulanc.

2. Set imobilizimi për frakturat e gjymtyrëve (splint tre masa)



- Përmasat e masës S jo më pak se (735 x 640 mm)
- Përmasat e masës M jo më pak se (1100 x 695 mm)
- Përmasat e masës L jo më pak se (1300 x 720 mm)
- Pompë alumini me vakum manual
- Xhepi i papërshkueshëm nga uji me hapësirën ruajtëse për vendosjen e pompës
- Të krijojë një dhomë të brendshme me vakum, që lejon shpërndarjen e parregullt të materialit të pjesës së brendshme, me saldim ultrasonik të gjerë.
- Përdorimin e materialit shumë rezistent, i cili gjithashtu është i lehtë për t'u pastruar dhe numri i madh e shiritave.
- Pozicioni i valvulave është i ndryshëm në të tre madhësitë në mënyrë që ato të mund të vendosen lehtësisht.

3. Bllokues i kollonës cervikale (qafore)




- Të jetë me përmasat jo më pak se 30x30 cm
- Të garantojë gjatë lëvizjes së të dëmtuarit një imobilizim sipas aksit anatomik të sigurt të vertebrave cervikale .
- Të sigurojë kontroll të lëvizjeve aksiale dhe përkuljeve laterale të kollonës.
- Të jetë e realizuar me material polietilieni me densitet të ulët, që siguron pastrim të lehtë.
- Të jetë fleksibël në aplikim, dhe me strukturë të ngurtë për imobilizim.
- Të ketë një hapje të përparme për të lehtësuar aksesin e trakeotomisë

4. Barrele (traume spinale) për shtyllen kurrizore dhe bllokues koke.



- Të përmbushë kërkesat ergonomike sipas standarteve ndërkombëtare
- Të jetë me përmasa jo më pak se 445 x 55 x 1830 cm dhe pesha të jetë nga 8 deri në 12kg, kapaciteti mbajtes i peshës jo më pak se 150 kg.
- Të jetë e përshtatshme për adultët dhe fëmijët.
- Të jetë nga material i përshtatshëm që të lejojë pastrimin dhe dezinfektimin nga infeksionet.
- Të ketë material ngjitës(velkro) për bllokuesin e kokës.
- Të ketë bllokues koke me ngjitës që vendoset dhe të jetë i montueshëm në barrelën spinale.



- Të jetë e përbërë nga material sfungjeri me densitet të lartë dhe nga jashtë e mbuluar me veshje hidrozistente.
- Të parandalojë çdo lëvizje të kokës së të dëmtuarit gjatë transportit.

5- Barrelë Luge

Barrelë në formë luge, e çmontueshme e kompletuar me rripat e sigurimit.

Barela në formë luge me dimensione si më poshtë:

Gjatësia jo më pak se 1 650 mm deri në 2 010 mm

Gjerësia: minimumi 400 mm

Gjatësia (e mbyllur): maksimumi 1 200 mm

Pesha jo më shumë se 11 kg

Pesha mbajtja jo më pak se 150 kg.

Materiali i barelës në formë luge duhet të jetë e fortë, e lehtë me hapësira anësore për futjen e dorës dhe lidhjen e rripave të sigurisë.

Duhet të jetë me gjatësi të rregullueshme për ngarkimin e pacientëve me përmasa të ndryshme.

Duhet të jetë e ndërtuar në mënyrë që të ndahet dhe bashkohen për përdorim sipas nevojës.

Forma duhet të jetë në konkave për të reduktuar në maksimum lëvizjet laterale.

Të ketë tre rripa sigurimi për mbrojtjen e pacientit dhe me hapje të shpejtë, me kapse femër-mashkull.



6. Sistem nxjerrje dhe imobilizimi spinal (KED, Kendrick Extrication Device)




KED është i përbërë nga një seri steka druri ose material tjetër i ngurtë i veshur me veshje në PVC për të garantuar higjienizimin dhe disinfektimin e shpejtë dhe efikas.

KED mbështjell kokën, kollonën cervicale dhe shtyllën kurrizore në një pozicion gjysëm të ngurtë, që lejon imobilizimin e kollonës në total. Në përgjithësi ka tre rripa në tre nivele me tre ngjyra të ndryshme dhe me dy rripa që kalojnë në kofshë dhe lidhen me KED.

- Të ketë përmasa jo më pak se 90 x 83 cm (gjat x gjer)
- Peshë jo më pak se 3 kg
- Të jetë i furnizuar me:
- Jastëk për t'u përdorur si mbushje për pjesën e prapme të qafës
- Të jetë e ngurtë në drejtim vertikal dhe fleksibilitet horizontalë
- Rripat dhe kapset të jenë të ngjyrosura për njohje të lehtë femër- mashkull.

7-Barrelë mushama:



- Me përmasa afërsisht 200x150 cm
- E përbërë nga; najlon 550 D polipropileni ,me ngarkesë thyerje deri në 600 kg, për të rritur elasticitetin dhe shiritat perforcues për kontrollin e ngarkesës deri në 600 kg.
- E pajisur me qepje të dyfishta dhe me ngjitje për rritjen e sigurisë, të gjitha të bëra me fibra najloni të qëndrueshme dhe që nuk çahen.

8- Spider(Rrip sigurimi)



- Të mundësojë një fiksion të shpejtë të të dëmtuarit në barrelën spinale, duke garantuar parandalimin e dëmtimeve të strukturave anatomike,
- Të mundësojë një imobilizim korrekt të kolonës dhe artikulacioneve, edhe gjatë transporteve në kushtë të vështira.
- Rripat të jenë prej materiali rezistent, elastik dhe shumë të qëndrueshëm, të kenë në pjesën fundore të tyre ngjitëse (velkro) që mundësojnë fiksimin e sigurt në barrel të pacientit dhe njëkohësisht të mundësojnë shkëputjen e lehtë prej saj, në momentin e heqjes së spiderit (rripit të sigurisë).

9- Gërshërë Robin



Të përbëra nga material celiku, mbështjellëse plastike, në pjesën e dorezave.

10. Pompe thithese portative (aspirator),volumi thithes min 1 000 ml, 12 V dhe 220 V.

Pompe thithese portative të jetë me karikues baterie. Të jetë elektrike dhe me bateri, me peshë nga 2- 3,5 kg. Motor me membranë sigurie për ndalimin e hyrjes së lëngjeve në motorin e aspiratorit. Të ketë depozitë për mbledhjen e sekrecioneve biologjike. Të ketë kabëll për ushqyes 220V dhe suport me qark karikimi.

11. Set diagnostikues i parametrave jetësor, i përbërë si më poshtë:

- Aparat tensioni portabël (sfigmomanometer), lehtësisht i lexueshem nga çdo kend. Manshetat e perfshira si për adult dhe pediatrik..
- Stetoskopi të përbëhet nga membranë që dedektojnë dhe amplifikojnë zhurmat kardiake dhe ato respiratore. Koka e përbërë prej inoksi që të dedektojë dhe tinguj me frekuenc të ulur.
- Termometri elektronik



Pajisja elektronike për matjen e temperaturës së trupit, i thjeshtë në përdorim dhe me precizion të lartë

-Pulsoksimetër për matjen e sasisë së oksigjenit në gjak.



-Glukometër dhe strishot për glukometër



Me sistem për matjen e sasisë së glukozës në gjak. Të
masë sasinë e glukozës në gjak, duke e nxjerrë atë nga shiritat në të cilën është hedhur një pikë e
gjakut kapilar, shiritat /strishot janë reactive në sajë të elektrodës me sensorë.

12. Monitordefibrilator per autoambulancat:

Të plotësojë karakteristikat si më poshtë:

- Të ketë selektor në tre pozicione
- Pozicion për defibrilim manual, dhe të sinkronizuar për goditje elektrike me piastra manuale.
- Pozicion AED(Automatic External Defibrillation), që do të thotë semiautomatik, që kryen defibrilim me piastra autoadezive.
- Pozicion monitorimi dhe regjistrimi të EKG(Elektrokardiograma).

Të ketë monitor me ngjyra TFT-LCD rezistent kundrejt goditjeve dhe demtimeve, ku te pasqyrohen 12 kanalet e EKG, saturimi i O₂, pulsi, parametrat jetësor, alarmet etj.

Diapazoni i shkarkimit te energji se 1-250J

Koha e karikimit te monitor defibrilatorit per goditje elektrike te jete jo me shume se 8 sekonda per 360 J

Minimumi i kohëzgjatjes se baterisë të jetë 8 orë

Impuls bifazik qe ndryshon sipas specifikave te pacientit ne Automatic Mode

Te identifikojë nese pacienti ka pacemaker te implantuar ose jo per sigurine e tij.

EKG 12 kanale

Pulsoksimetri (saturimi i O₂)

Mates tensioni NIBP per te rritur dhe neonatal

Printer termal te integruar per te printuar EKG-ne 12 kanalshe

Rrip mbajtës dhe xhepa anësore te integruar per ruajtje nga demtimet dhe transport te shpejte te aksesoreve

Memorje per ruajtjen e te dhenave minimum 3 GB

Elektroda pediatrike dhe adulte te integruara

Elektroda ngjitese per defibrilim automatic dhe pacemaker

Aksesor SPO₂ Pulsoksimetri

Aksesor NIBP(presioni arterial)

Mbajtës dhe karikues baterie ne levizije,

13. Karroca/Karrige Transportuese pacienti



Karriget të karakterizohen nga konstruksion alumini,
Doreza të pasme të palosshme anti rrëshqitëse,
Doreza të përparme, të zgjatshme, me mekanizëm bllokimi dhe zhblokimi.
Ndenjësja e kariges të jetë me material PVC ose Najlon,
Mbështetësja e shpinës të jetë me material PVC ose PE, antirrëshkitës,
Rrotat e pasme me diametër të madh, rrotat e përparëme të xhirueshme, të pozicionueshme me bllokues.

E pajisur me mbështetëse për vendosjen e këmbëve të pacienti, si dhe dy rripa për bllokimin e pacientit në karrige.

Karroca duhet të ketë një kapacitet të paktën 180 kg.

Pesha e karrocës nuk duhet të kalojë 10 kg.

Sistemi I fiksimit në dyshemenë e autoambulancës.

14. Çanta e autoambulancës

Çanta e emergjencës për autoambulanca të ndihmës së parë të jetë multifunksionale, duhet të jetë me përmasa jo më pak se 60x20 cm

- Me qepje dhe me ngjitje
- Me ndarje të brëndshme, 5 çanta të vogla
- Të jetë me zinxhirë, që çmontohet në pjesë të ndryshme.
- Të ketë xhepa anësore me zinxhirë
- Komode në pjesën e shpinës, dhe me rripat me sfungjer
- Të jetë e përshtatshme për vendosjen e seteve të ndryshme (infuzioni, mjekimi, intubimi etj)
- Të jetë e përbërë nga material shumë rezistent me kapacitet të lartë mbajtës dhe me strisho fosforeshente.



(Foto ilustruese e cantave të vogla)

15-Pompe Shiringe

Për injeksion të kontrolluar të dozave të medikamenteve nëpërmjet aksesit venoz.

16- Frigorifer autoambulance:

Të jetë frigorifer ftohës dhe ngrirës për autoambulanca për mbajtjen e medikamenteve që duhen ruajtur në temperature të ulta.

Ngrirës mjekësor për transport medikamentesh, organesh, dhe hemoderivate me temperature të kontrolluar.

Të jetë frigorifer ftohës dhe ngrirës.

Volumi: 10 deri në 15,5 litra.

Tensioni: 12V/24Vdc. (230V ushqyes/trasformatore,

Temperatura: Nga rreth +10°C deri në -18°C me termostat elektronik me Led.

Kontrolli automatik i bateris në tre nivele.

Dritae brendshme me LED

Të ketë: kavo ushqyese me spina karikimi makine, me dorez transporti.

17-Set lindje

Të jetë i pajisur me materialet dhe paisjet standarte për lindje si bisturi nje përdorimshme, klema, gërshërë, doreza sterile, bende sterile, e tj.



18-Set djegje

Të jetë i pajisur me materialet dhe paisjet standarte për djegie, si bisturi nje përdorimshme, gërshërë, doreza sterile, bende sterile, set steril dhe nitrat argendi pomadë e tj.

19-Ventilatori Pulmonar

Ventilatori pulmonar i lëvizshëm për autoambulancë.

I kontrolluar me mikroprocesor të kontrolluar me kohë dhe me presion të kufizuar.

Me ekran të thjeshtë me butona me zgjedhje me dimensione të mëdha.

Mbrojtje kundër aktivizimit aksidental të butonit zgjedhës AIR MIX dhe e asaj ON/OFF.

Manometër me ngjyrë për identifikimin e menjëhershëm të llojit të ventilimit.

Butonat të rregullimit në sfond me kontrast të lartë për një identifikim të mirë të parametrave të rregullueshëm.

Struktura në alumin të fortë, mbrojtëse ansor kundër goditjeve aksidentale, raporti i I/E

konstant, alarmi për monitorimin e ventilimit dhe menaxhimin. Përmasat 270*177*210 ± 20mm.

Pesha nga 3.5 - 4 kg.

Alarmi me presion të lartë- ushqim pneumatik – bateria e shkarkuar (dy nivele). Niveli zanor i alarmit 80 ± 10 db. Koha e ndalimit të alarmit minimum 60s. Frekuenca respiratore 5-40 bpm.

Fluksi i oksigjenit nga 2-20L/min. Rregullim i valvulës Sovrapp nga 20-60 cm H2O. Raporti I/E

1:2. Koncentrimi i O₂ 60% ose 100%. Manometri nga -20 deri në +80 m bar. Standarti me lidhje pneumatike UNI mbrojtje IP 24, klasifikimi klase e dytë ose lidhja tërësisht me ushqim elektrik të jashtëm nëpërmjet lidhjes së prizës 12V ose transformatorit të aporovuar AC/ DC 100/240 Vac, 50-60 Hz (opsionale).

Bateri e brendëshme Ni-Mh e rikarikueshme. Kohëzgjatja e baterisë minimumi 3H, sipas standartit EN 794-3 EN 1789, EN 60601-1, EN 60601-1-2, EN 60601-1-8, UN/ECE

SHENIM: Te gjitha fotot e pasqyruara në këtë material janë foto ilustruese dhe nuk i referohen asnjë prodhuesi dhe modeli konkret.



Shtojca11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës

Dokumentat Standarde të Tenderit

Nr.		
01		
02		
03		
...		



Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Loti I. “Blerje autoambulancë modeli A”

Nr.	Emertimi i mallit	Njësia	Cmimi njësi pa TVSH	Sasia	Vlera pa TVSH
1	Autoambulancë modeli A	cope		30	
	Fondi limit pa TVSH				184,095,170

Loti II. “Blerje autoambulancë modeli C”

Nr.	Emertimi i mallit	Njësia	Cmimi njësi pa TVSH	Sasia	Vlera pa TVSH
1	Autoambulancë modeli C	copë		2	
	Fondi limit pa TVSH				14,544,841

Afatet e lëvrimit:

Nga data e lidhjes së kontratës deri më 17 dhjetor 2018.

Shtojca 13

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

Shtojca 14

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Dokumentat Standarde të Tenderit

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Dokumentat Standarde të Tenderit

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
Vlera _____	
<i>(me numra dhe fjalë)</i>	

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
Vlera _____	
<i>(me numra dhe fjalë)</i>	

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME **Mallrat – Tender i Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.

- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që

kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intellektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së

mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës se shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.

- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
